



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POLIÇAN  
AUTORITETI KONTRAKTOR

.....  
Adresa: Lagjia "Qender" Poliçan ; Tel:036824200 ; Email: njvbashkiapoliçan@gmail.com

Nr. 842/15 Prot

Poliçan , me 10.05.2017

**KONTRATË SIPËRMARRJE**

**OBJEKTI :**

" RIKUALIFIKIMI I FASADAVE NE SHETITOREN MIQESIA DHE  
REABILITIMI I RRUGES SE TREGUT"

**REFERENCA 74058-03-27-2017**

**2017**



## KONTRATE SIPERMARRJE

"RIKUALIFIKIMI I FASADAVE NE SHETITOREN MIQESIA DHE REABILITIMI I RRUGES SE TREGUT"

## KONTRATË SIPËRMARRJE

"RIKUALIFIKIMI I FASADAVE NE SHETITOREN MIQESIA DHE REABILITIMI I RRUGES SE TREGUT"

Lidhur sot me date 10.5.2017 ne baze te nenit 850 dhe ne vazhdim te Kodit Civil, ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimet publike" me ndryshimet perkatese , VKM nr.914 date 29.12.2014 "Miratimin e rregullave te prokurimit Publik" , akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi midis paleve :

- **Bashkise se Poliçanit** e perfaqesuar nga Z. Adriatik Zotkaj , Kryetar i bashkise , ne cilesine e Titullarit te Autoritetit Kontraktor, me adresë: Shëtitorja "Miqesia " , Lagjia Qender , Polican , qe më poshtë do te quhet "Autoriteti Kontraktor"; dhe **Operatorit ekonomik " Totila " sh.p.k** , regjistruar respektivisht si më poshtë shënuar:

Shoqëria "Totila " sh.p.k. regjistruar me Vendim Gjykate Nr. 20816 date 12.02.1999 , me license profesionale te shoqerise NZ. 3191/6, me vlefshmëri me afat kohor deri me 21.06.2021 , dhe license te re lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastruktures, me seli te shoqerise: Berat, Barrikad, me NUIS K13001010G e përfaqesuar nga Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë Z. Jemin Toto, i mëposhte quajtur Kontraktor.

**Neni I. Te pergjithshme ,**

**Neni 1.1 Objekti i kontrates**

1.1 Objekti i kësaj kontrate eshte sipermarrja me objekt: " Rikualifikimi i fasadave ne shetitoren miqesia dhe reabilitimi i rruges se tregut"ne përputhje të plote me projekt - zbatimin e objektit , specifikimet teknike dhe cdo dokument tjetër bashkelidhur dokumentave standarte te tenderit.

**Neni 1.2 Vlera e kontrates**

1.2 Kontrata lidhet me nje vlere totale prej **6 884 220 (gjashte milion e teteqind e tetedhjte e kater mije e dyqind e njezete ) leke pa tvsh dhe 8 261 064 (tete milion e dyqind e gjashtedhjte e nje mije e gjashtedhjte e kater )leke me tvsh.**

Fond eshte vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit sipas Vendimit te Komitetit per zhvillimin e Rajoneve nr.8 date 13.2.2017 "Per shperndarjen e financimit per projektet , thirrja e katert per vitin 2016"Granti Infrstruktura vendore dhe rajonale " , Programi i zhvillimit te infrastruktures vendore dhe rajonale , shtuylla I, celur fondi sipas shkreses nr. 2456/2 prot dt 6.3.2017 te drejtorise se financave vendore , MF.

Kontraktori merr persiper kryerjen e githe zerave te punimeve brenda afatit te kryerjes se punimeve 2 muaj sipas grafikut te zbatimit te punimeve , ne te cilen do te bej dorezimin e punimeve brenda afatit te parashikuar .

Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontrates nuk duhet të ndryshojne nga çmimet e ofruara nga kontraktori në oferten e tij.



## KONTRATE SIPERMARRJE

### "RIKUALIFIKIMI I FASADAVE NE SHETITOREN MIQESIA DHE REABILITIMI I RRUGES SE TREGUT"


#### Neni 1.3 Afati realizimit

1.3 Afati maksimal i përfundimit total te punimeve per ekzekutimin e gjithë zerave te preventivit eshte 2 muaj ose 60 dite kalendarik nga data e nenshkrimit te kontrates ose marrjes ne dorezim te sheshit te punimeve sipas grafikut per realizimin e punimeve .

Gjuha në të cilën përpilohet kontrata eshte Gjuha Shqipe.

#### Neni 2: Përkufizime

- 2.1 "Preventiv total" do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 "Preventiv per njesi" do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 "Afati i realizimit te punimeve" do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 "Cmim kontrate" do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 "Realizimi i punimeve" do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 "Defekt" do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 "Data e hyrjes" do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 "Data e fillimit" eshte perfshire ne Të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur kontraktori do të filloje punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, "data e fillimit "do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 "Pajisje" do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 "Materiale" do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 "Objekt i kontratës" do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 "Palë(t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.



## KONTRATE SIPERMARRJE

### "RIKUALIFIKIMI I FASADAVE NE SHETITOREN MIQESIA DHE REABILITIMI I RRUGES SE TREGUT"


- 2.14 "Drejtues projekti" do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 "Autoritet Kontraktor" do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktin punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 "Kantier" do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 "Raport i inspektimit të kantierit" do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 "Nënkontraktues" do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 "Kontraktor" do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 "Standarte Teknike" do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 "Ngritja e kantierit" do të thotë punimet e ndertimit të perkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 "Punime" do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit

### Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.
- 3.3 Te gjitha dokumentat e tenderit të dhena nga autoriteti kontraktor dhe të mara në formën e ofertes nga kontraktori janë pjesë perberse dhe integrale e kësaj kontrate.

### Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor Bashkia Polican mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori Totila shpk ka kryer veprime të korrupsionit. Veprimet e korrupsionit përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.



*afet 201*



## KONTRATE SIPERMARRJE

### "RIKUALIFIKIMI I FASADAVE NE SHETITOREN MIQESIA DHE REABILITIMI I RRUGES SE TREGUT"


- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Totila shpk duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor Bashkine Polican të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

#### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës.
- 5.3 Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

#### **Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori Totila gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Bashkise Polican i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Totila shpk, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Bashkise Polican të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Totila shpk kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.



## KONTRATE SIPERMARRJE

### "RIKUALIFIKIMI I FASADAVE NE SHETITOREN MIQESIA DHE REABILITIMI I RRUGES SE TREGUT"

#### **Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

#### **Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor .
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

#### **Neni 9: Komunikimi**

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

#### **Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët**



- 10.1 Kontraktori totila shpk nuk duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit te punimeve.

#### **Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

- 11.1 Autoriteti Kontraktor Bashkia Polican ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin Totila shpk për dëmtime të pajisjeve të këtij te fundit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim te rastit kur keto te fundit, kishin gabime te dukshme qe mund te ishin konstatuar lehtesisht nga kontraktuesi.

#### **Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet



## KONTRATE SIPERMARRJE

### "RIKUALIFIKIMI I FASADAVE NE SHETITOREN MIQESIA DHE REABILITIMI I RRUGES SE TREGUT"

me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

#### **Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

- 13.1 Kontraktori Totila shpk duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori Totila shpk nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Bashkia Polican .

#### **Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve**

- 14.1 Totila shpk duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe te marr sheshin e ndertimit ne dorezim dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit 60 dite sipas grafikut te punimeve .

#### **Neni 15: Ngritja e Kantierit**


- 15.1 Kontraktori Totila shpk mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes se Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

#### **Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

- 16.1 Kontraktori Totila shpk do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
- 16.2 Kontraktori Totila shpk do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike te rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

#### **Neni 17: Zbulimet**

- 17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen per te vepruar konform legjislacionit ne fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.



## KONTRATE SIPERMARRJE

### "RIKUALIFIKIMI I FASADAVE NE SHETITOREN MIQESIA DHE REABILITIMI I RRUGES SE TREGUT"

#### Neni 18: Disponimi i Kantierit

18.1 Autoriteti Kontraktor Bashkia Polican duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

#### Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit

19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .

19.2 Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

#### Neni 20: Paralajmërimi në Kohë

20.1 Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afat .

#### Neni 21: Kontrolli i Cilësisë

21.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.


21.2 Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

21.3 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

21.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

#### Neni 22: Defektet e Pakorrigjuara

22.1 Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarise koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.





## KONTRATE SIPERMARRJE

### "RIKUALIFIKIMI I FASADAVE NE SHETITOREN MIQESIA DHE REABILITIMI I RRUGES SE TREGUT"

#### Neni 23: Përgjegjësitë e Autoriteti Kontraktor

23.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit të Plote, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për:

- (a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/ kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.
- (b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

#### Neni 24: Përgjegjësitë e kontraktorit

24.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas Nenit 23.

#### Neni 25: Sigurimi

25.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor Bashkise Polican dhe kontraktorit Totila shpk, nga data e hyrjes në kantier deri në afatin e realizimit të plote, në shumat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

25.2 Policia e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.



25.3 Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.

#### Neni 26: Testimet dhe Inspektimet

26.1 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës

26.2 Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto testime dhe inspektime.

26.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë testime ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testimeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e



## KONTRATE SIPERMARRJE

### "RIKUALIFIKIMI I FASADAVE NE SHETITOREN MIQESIA DHE REABILITIMI I RRUGES SE TREGUT"

punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

26.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

26.5 As ekzekutimi i testeve as inspektimi i punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

#### **Neni 27 Garancitë**

27.1 Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.

27.2 Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

27.3 Garancia e difekteve do te jete 5 % e vleres se kontrates qe do ti mbahet nga cdo situacion. Kontraktorit si garanci per cilesine e punimeve, shume e cila do te paguhet mbas perfundimit te periudhes se garancise se punimeve, duke mare parasysh edhe sanksione e parashikuara ne kete kontrate.

#### **Neni 28: Çmimi i Kontratës**

28.1 Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij .

#### **Neni 29: Kushtet e Pagesës**

29.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhen siç specifikohet në kontratë.

29.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet më një dispozitë tjetër në kontratës, pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë në ditën kur është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe i përcaktuar në kontratë.

29.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori ka të drejtë të marrë pagesa periodike gjatë progresit të zbatimit të projektit. Grafiku i pagesave periodike do të parashikohet në KVK. Kur bëhet një pagesë e parashikuar, kontraktori duhet të paraqese nje deklarate me situacionin e muajit tek drejtuesi i projektit ku deklaron se plani sipas grafikut është përbushur. Komunikata gjithashtu duhet të shprehë vlerën e punës së ekzekutuar duke hequr shumën e grumbulluar të verifikuar më parë, si dhe shumën e pagesës paraprake të papaguar dhe çdo shumë të mbajtur në pritje të korrigjimit të një defekti.





## KONTRATE SIPERMARRJE

### "RIKUALIFIKIMI I FASADAVE NE SHETITOREN MIQESIA DHE REABILITIMI I RRUGES SE TREGUT"

- 29.4 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.
- 29.5 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa e periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga drejtuesi i projektit.
- 29.6 Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.
- 29.7 Pagesa e situacioneve do të kryhet në llogarinet bankare pranë Bankës Kombëtare Tregtare me kod IBAN AL 3420523132137432CLPRCLALLJ .
- 29.8 Financimi i objektit me fonde të vena në vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit sipas Vendimit të Komitetit për zhvillimin e rajoneve nr.8 date 13.2.2017 "Për shpërndarjen e financimit për projektet , thirrja e katert për vitin 2016" Granti Infrastruktura vendore dhe rajonale " , Programi i zhvillimit të infrastrukture vendore dhe rajonale , shtylla I, celur fondi sipas shkresës nr. 2456/2 prot dt 6.3.2017 të drejtorisë së financave vendore , MF.
- 29.9 .Pagesa e situacioneve do të kryhet sipas financimit të parashikuar në pikën 1.2 të nenit 1 të kësaj kontrate.

#### **Neni 30: Vonesa në Bërjen e Pagesës**

- 30.1 Shpërblimi për demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamatën e arritur nga data e fillimit të vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.
- 30.2 Kamata ligjore paguhet pa qene i detyruar kreditori ( kontraktori) të provojë ndonjë dem. Nëse kreditori (kontraktori) provon se ka pesuar një dem me të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor ) duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.
- 30.3 Rastet e kompensuara për të cilën vonesa në pagesë justifikohet do të konsiderohen si vijon:
- a) Mbikqyesi i Punimeve urdheron shtyrjen ose nuk jep skicat (vizatimet) specifikimet ose udhëzimet e nevojshme për kryerjen e punimeve në kohën e caktuar.
  - b) Mbikqyesi i Punimeve udhëzon Kontraktorin për të zbuluar punimet e fshehta ose për të kryer provat pas kryerjes së punimeve.
  - c) Autoritet Publikë ose Autoriteti Kontraktor shkaktojnë vonesa në lirimin e sheshit të ndrtimit për Kontraktorin.
  - d) Autoriteti Kontraktor vonon pa arsye leshimin e certifikates së marrjes në dorezim.
- 30.4 Kompensimi i rasteve të sipërmendura do të bëhet si vijon:  
Për vonesat e permendura në pikat 30.3 (a,b,c,d) Autoriteti Kontraktor do të njohë shtyrjen e dates së përfundimit të punimeve mbi ato të parashikuar në këtë kontratë.



## KONTRATE SIPERMARRJE

### "RIKUALIFIKIMI I FASADAVE NE SHETITOREN MIQESIA DHE REABILITIMI I RRUGES SE TREGUT"

#### Neni 31: Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

31.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

#### Neni 32: Forca Madhore

32.1 Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

32.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

32.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Blerësin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

#### Neni 33: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit


33.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

33.2 Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

33.3 Autoriteti Kontraktor mund të zbrisë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

33.4 Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

33.5 Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është



## KONTRATE SIPERMARRJE

### "RIKUALIFIKIMI I FASADAVE NE SHETITOREN MIQESIA DHE REABILITIMI I RRUGES SE TREGUT"

dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

#### **Neni 34: Dëmet e Likuidueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve**

34.1 Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

- a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
- b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
- c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

#### **Neni 35: Negociatat dhe Amendamentet**

35.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit.

35.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.

35.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.


#### **Neni 36: Ndryshimi i Porosisë**

36.1 Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegociimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

36.2 Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuar në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit original të kontratës.

36.3 Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

- a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
- b) Korrigjime në materiale
- c) Korrigjime në sasi



## KONTRATE SIPERMARRJE

### "RIKUALIFIKIMI I FASADAVE NE SHETITOREN MIQESIA DHE REABILITIMI I RRUGES SE TREGUT"



- 36.4 Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materilizojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshjes.
- 36.5 Ndryshimi i porosise nuk do te jete i vlefshem nese nuk formalizohet sipas kerkesave te Nenit 35 te ketyre kushteve te pergjithshme.

#### **Neni 37: Preventivi për Njësi ose në Total**

- 37.1 Kontrata do të përfshijë një Preventiv në Total nëse është një kontratë me shumë totale ose një Preventiv për Njësi nëse është një kontratë me çmim njësie. Nëse është një kontratë me çmim njësie, preventivi për njësi do të përmbajë volumet e zërave të ndërtimit, instalimin, testimin dhe komisionet që bëhen nga kontraktori.
- 37.2 Preventivi për Njësi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh.

#### **Neni 38: Mbarimi dhe marrja përsipër e ndërtimeve**

- 38.1 Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe drejtuesi i projektit do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.
- 38.2 Nëse drejtuesi i projektit zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japi udhëzime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zerrat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.
- 38.3 Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në Punime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.
- 38.4 Demtimi i punimeve ose humbja e materialeve që do të perdoren për punimet nga dita e fillimit deri në marjen në dorezim si dhe gjatë afatit të garancise së defekteve do të mbulohet nga Kontraktori me shpenzimet e tij neqoftese humbja ose demtimi jane shkaktuar nga gabimet e veprimeve te tij.
- 38.5 Riparimet që dalin të nevojshme gjatë kolaudimit të vepres, nëse janë për shkak të mosplotësimit të kontratës ose të punës jo cilësore të Kontraktorit do të mbulohen nga ky i fundit me shpenzimet e tij.
- 38.6 Mbas marrjes së gjithë dokumentacionit Autoriteti Kontraktor i paraqet komisionit të kolaudimit gjithë dokumentacionin e realizimit të objektit. Me përfundimin e procedurave të kolaudimit Autoriteti Kontraktor lëshon certifikatën e marrjes në dorezim të punimeve të kryera dhe do të cillojë garancinë e sigurimit të Kontrates. Nga data e akt-kolaudimit të punimeve fillon periudha e garancise së punimeve.



## KONTRATE SIPERMARRJE

### "RIKUALIFIKIMI I FASADAVE NE SHETITOREN MIQESIA DHE REABILITIMI I RRUGES SE TREGUT"

38.7 Ne fund të periudhës së garancisë së punimeve, Mbikqyresi i Punimeve dhe komisioni i manjës në dorezim të objektit do të përpilojnë së bashku me Autoritetin Kontraktor aktin manjës në dorezim të veprës, objekt i kësaj kontrate.

#### **Neni 39: Ndërprerja për Mosplotësim**

39.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

- a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
- b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

39.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

39.3 Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim të kushteve të saj

#### **Neni 40: Ndërprerja për Shkak të Falimentimit**

40.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.

40.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

#### **Neni 41: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

41.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.


41.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

41.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuar dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeshme të Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

#### **Neni 42: Nënkontraktimi**

42.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë.

42.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohen dhe dokumentacinin që provon



## KONTRATE SIPERMARRJE

### "RIKUALIFIKIMI I FASADAVE NE SHETITOREN MIQESIA DHE REABILITIMI I RRUGES SE TREGUT"

aftësine e nën-kontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

- 42.3 Cdo nenkontraktor duhet te kete te drejte te marre pjese ne prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për punët që do të kryejë
- 42.4 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nenkontraktorit .

#### **Neni 43: Transferimi i të Drejtave**

- 43.1 Kontraktori nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

#### **Neni 44: Sigurimi i Kontrates**


- 44.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet ti dorëzojë Autoriteti Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar . Konkretisht ne shumën: 826 106.4 leke e pranueshme sic specifikohet ne kontrate. Deshtimi per te dhene sigurimin e kontrates ne formen dhe ne shumën e kerkuar brenda 30 diteve do te rezultoi ne anulimin e kontrates dhe humbjen e sigurimit te ofertes te kontraktorit.
- 44.2 Shuma e sigurimit te kontrates duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktori në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 44.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

#### **Neni 45: Baza Ligjore**

- 45.1 Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

#### **Neni 46: Zgjidhja e Mosmarrveshjeve**

- 46.1 Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.
- 46.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.





## KONTRATE SIPERMARRJE

"RIKUALIFIKIMI I FASADAVE NE SHETITOREN MIQESIA DHE REABILITIMI I RRUGES SE TREGUT"

### Neni 47: Përfaqësimi i Palëve

- 47.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukture organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.
- 47.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 47.3 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

### Neni 48: Lajmërimet


- 48.1 Çdo lajmërim, komunikim, njoftim, miratim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë, nese ka ndryshim te adreses palet jane te detyruar te njoftojne per cdo ndryshim.

### Neni 49: Llogaritja e Afateve

- 49.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

### Neni 50: Mbikqyresi i Punimeve

- 50.1 Mbikqyresi i punimeve per realizimin e kontrates do te jete DRICON referuar kontrates se lidhur me dt 8.5.2017 midis Bashkise Polican ne cilesine e Autoritetit Kontraktor dhe Vladimir Topi me cilesin e mbikqyresit te punimeve . Detyrat e mbikqyresve te punimeve burojne nga aktet liglore dhe n/ligjore ne fuqi dhe jane te detajuara ne kontraten e sherbimit te lidhur me keta te fundit.
- 50.2 Ne rast se mbikqyresi do te ndryshohet Autoriteti Konfaktor njofton menjehere Kontraktorin.
- 50.3 Mbikqyresi i Punimeve do te vendose per ceshtjet e kontratde midis Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.
- 50.4 Mbikqyresi i Punimeve mund te delegoje ndonje nga detyrat dhe pergjegiesite e tij te te tjeret pervec zgiidhjes se mosmarreveshjeve dhe konflikteve. Mbikqyresi i punimeve duhet te njoftoj me shkrim Kontraktorin per delegimet e bera apo te deleguara.
- 50.5 Mbikqyresi i punimeve duhet te kontrolloje Punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet te verifikoje shumen qe duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 20 diteve pune nga data qe kontraktori paraqet komunikaten e tij tek drejtuesi i projektit.
- 50.6 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kontrate, pagesa periodike per punet do te behet brenda 30 diteve kalendarike nga data qe progresi i grafikut te zbatimit eshte verifikuar nga mbikqyresi i punimeve.



## KONTRATE SIPERMARRJE

"RIKUALIFIKIMI I FASADAVE NE SHETITOREN MIQESIA DHE REABILITIMI I RRUGES SE TREGUT"

### Neni 51. Personeli i Kontraktori

51.1 Kontraktori eshte i detyruar te punesoje ne kantier per kryerjen e funksioneve te parashikuara ne programin e miratuar nga Mbikqyresi i punimeve vetem personelin inxhinierik te deklaruar ne oferte.

51.2 Mbikqyresi i Punimeve do ti propozoje Autoritetit kontraktor per te zevendesuar personelin kryesor vetem neqoftese kualifikimet dhe aftesit e tyre te nevojshme jane baraz ose me te larta se ato te personelit te percaktuar ne oferten e Kontraktor.

51.3 Ne qofte se Mbikqyresi i Punimeve i kerkon Kontraktorit qe te largoje nje person, i cili eshte anetar i personelit ose i fuqise punetore te Kontraktorit, duhet theksuar arsyeja . Kontraktori do te marre masa per te siguruar qe personi ne fjale te largohet nga kantieri i punimeve brenda 72 oreve dhe te mos kete me lidhje me punen e perfshire ne kontrate.

51.4 Kontraktori eshte i detyruar te caktoj Drejtorin Teknik. Drejtori teknik eshte personi qe Kontraktori ka percaktuar ne oferten e tij. Drejtuesit Teknik te punimeve te objektit do te jete ing. ndertimi Alma Mbrati i perfshire ne licencen profesionale te shoqerise "Totila " shpk, me NZ. 3191/6, leshuar nga Ministria e Transportit.dhe Infrastruktures.

Detyrat e Drejtorit Teknik te Punimeve jane si me poshte:



- a) Zbatimin e objektit konform projektit dhe kushteve teknike te zbatimit
- b) Te jete i pranishem gjate gjithë kohes se zbatimit te punimeve ne kantier;
- c) Te jete i pranishem dhe te perfaqesoje Kontraktorin ne te gjitha kontaktet, takimet zyrtare apo mbledhjet qe Autoriteti Kontraktor zhvillon me Kontraktorin dhe Drejtorin e Projektit ne zgjidhjen e diskutimin e ceshtjeve teknike e profesionale qe lindin gjate zbatimit te punimeve;
- d) Eshte pergjegjes per dokumentacionin teknik qe eshte i detyrueshem te mbahet ne objekt;
- e) Mban Korrespondencen zyrtare me Mbikqyresin e punimeve;
- f) Eshte pergjegjes per ecurine e zbatimit te punimeve konform plan organizimit dhe grafikut te punimeve;
- g) Eshte i pranishem ne te gjitha fazat e realizimit te objektit: zbatimin e punimeve.dorezimin dhe kolaudimin e objektit.

51.5 Ne rast se ndryshohet Drejtuesi Teknik, Kontraktori duhet detyrimisht te lajmeroje Mbikqyresin e Punimeve i cili ve ne dijeni Autoritetin Kontraktor.

51.6 Drejtuesi teknik ne kete rast duhet te kete te gjitha kualifikimet e kerkuara ne dokumentat e tenderit per Drejtuesin teknik. Autoriteti Kontraktor mund te kundershtojë emerimin e Drejtuesit Teknik nese vlereson se ai nuk permbush kualifikimet e percaktuara ne Dokumentat e tenderit. Ne kete rast Kontraktori cakton nje Drejtues teknik tjetër dhe detyrimisht lajmeron Mbikqyresin e Punimeve i cili ve ne dijeni Autoritetin Kontraktor.

### Neni 52 : Taksat

52.1 Kontraktori eshte i detyruar te paguaje te gjitha taksat ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar. Per taksat e percaktuara ne legjislacionin qe ka hyre ne-fuqi 28 dite para dates se hapjes se tenderit, te cilat Kontraktori duhet ti kete mare parasysh ne vleren e kontrates, Autoriteti Kontraktor nuk do ti njohë asnje shtese pagese.



## KONTRATE SIPERMARRJE

### "RIKUALIFIKIMI I FASADAVE NE SHETITOREN MIQESIA DHE REABILITIMI I RRUGES SE TREGUT"

52.2 Nese Kontraktori nuk eshte i regjistruar si subjekt qe ushtron aktivitet ne qytetin e Policanit eshte i detyruar te shlyeje ato taksa dhe tarifa vendore qe kane te bejne me realizimin e aktivitetit te perkohshem ne qytetin e Policanit .

#### **Neni 53: Zgjidhja e kontrates.**

53.1 Autoriteti Kontraktor ose Kontraktori mund te pezulloje kontraten kur veren shkelje themelore te saj .

53.2 Shkeljet themelore te kontrates perfshijne por nuk kufizohen ne sa vijon:

- a) Kontraktori nuk fillon pune brenda 5 diteve nga fillimi i zbatimit te kontrates si dhe ne rastet kur ndalohen punimet me shume se 10 dite kur nuk parashikohet ne programin e punes dhe ndalimi i punimeve nuk eshte i autorizuar nga Mbikqyresi i Punimeve dhe nuk respektohet grafiku i punimeve.
- b) Mbikqyresi i Punimeve udhezoi pezullimin e punimeve duke njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Kontraktorin.
- c) Kontraktori falimenton ose fillon likuidimin per arsye te tjera pervec rindertimit ose bashkimit te shoqerise.
- d) Kontraktori vonon kryerjen e punimeve dhe nuk realizon korigjimet e difekteve te propozuara nga Mbikqyresi i Punimeve.
- e) Autoriteti Kontraktor mund te nderpresd kontraten per shkak te Interesit Publik, ne cdo kohe nese gjykon se ky veprim duhet ndermarr per ti sherbyer me mire interesit publik.

#### **Neni 54 Pagesa pas Zgjidhjes se Kontrates**

54.1 Ne rast se kontrata priset nga Autoriteti Kontraktor per arsye objektive, Mbikqyresi i Punimeve do te leshoje nje certifikate per vleren e punes se kryer duke zbritur pagesat e marra deri ne ditën e leshimit te Certifikates.

#### **Neni 55. Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve**

55.1 Nese pas dates se nenshkrimimit te kontrates, ndonje ligj, rregullore, urdherese, urdher ose procedure me efektin e ligjit ne Republiken e Shqiperise hyn nd fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke perfshire datën e dorezimit, ose cmimin e ekushtet ose cmimi i kontrates do te negullohen ne ate mase sa kontraktori eshte ndikuar ne permbushjen e detyrimeve te tij sipas kontrates.

#### **Neni 56. Dispozita te Fundit**

56.1 Kjo kontrate do te quhet e vlefshme duke filluar nga data e nenshkrimimit te saj nga te dy palet. Te gjitha referencat e diteve do te jene kalendarike. Pjese perberse e kontrates jane gjithë dokumentat e tenderit, dhe dokumentat e operatorit ekonomik, oferta, grafiku i punimeve dhe ndarja e zerave te preventivit sipas perqindjes se pjesemarrjes.

Kjo kontrate perbehet nga 20 njezete flete, u hartua ne 6 (gjashte) kopje, kater nga te cilat i mban Autoriteti Kontraktor dhe dy kopje i mban Kontraktori.

**KONTRAKTORI :**  
"TOTILA" SHPK

**AUTORITETI KONTRAKTOR:**  
BASHKIA POLIÇAN

**PERFAQESUESI LIGJOR**

**JEMIN TOTO**

**TITULLARI**  
**AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**ADRIATIK ZOTKAJ**

